HIGJIENA SH.A.
03/BORDI 1043
36 31/10/2022
DEÇAN DEČANI

# BIZNES PLANI
# N.P.L ”HIGJIENA” DEÇAN
# 2023

HIGJIENA

HIGJIENA SH.A.
03/BORDI 1043
36 31/10/2022
DEÇAN DEÇANI

# BIZNES PLANI

# N.P.L ”HIGJIENA” DEÇAN

# 2023

Deçan
2022

# Përmbajtja

Përmbledhje ....................................................................................................5
Aktivitetet e ndërmarrjes ....................................................................................6
Historiku ...........................................................................................................7
Profili i komunës së Deçanit ...............................................................................8
Sasia dhe përbërja e mbeturinave ....................................................................16
Përbërja e mbeturinave ...................................................................................17
Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave dhe forma e deponimit ......................18
Aspekti organizativ dhe financiar i menaxhimit të mbeturinave .........................21
Plani Operativ ..................................................................................................22
Analiza e Tregut ...............................................................................................23
Analiza SWOT ..................................................................................................23
Përparsit ........................................................................................................24
Dobesitë .........................................................................................................25

Mundësitë ..... 25
Rreziqet ..... 25
Strategjia e Marketingut ..... 26
Menaxhmenti ..... 26
Qëllimet dhe Objektivat ..... 26
Vizioni ..... 28
Misioni ..... 28
Indikatorët e performancës ..... 29
Monitorimi ..... 30
Shërbimet për grumbullimin e mbeturinave ..... 31
Qasja për rritjen dhe mbajtjen e shkallës së synuar në treg ..... 31
Marrëdhënjet me klient ..... 31
Vetëdijësimi i popullatës ..... 32
Kostoja financiare ..... 33
Mirëmbajtja dhe amortizimi ..... 33
Fuqia punëtore ..... 33
Tarifat dhe të Hyrat ..... 35
Të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara të ndërmarrje për 2022-2023 ..... 36

## Përmbledhje

Ky plan i biznesit është dokument themelor i zhvillimit të ndërmarrjes për vitin 2023 i cili definon qartë misionin, synimet dhe rezultatet e pritura, duke bërë krahasimet me të arriturat e periudhave të kaluara. Plani i biznesit është përgatitur në bashkëpunim me zyrtarët e ndërmarrjes duke u bazuar në gjendjen ekzistuese dhe misionin e zhvillimit të ndërmarrjes në trajtimin dhe grumbullimin e mbeturinave sipas standardeve dhe praktikave evropiane.

Sipas Ligjit dhe rregulloreve Plani i Biznesit hartohet si dokument ku përshkruhen rrugët dhe mënyrat bazë për menaxhimin e Ndërmarrjes në të ardhmen , si të arrihet një cilësi dhe afarizëm sa më i mirë gjatë operimit të ndërmarrjes në shërbimin e grumbullimit dhe bartjen e mbeturinave ne deponi si veprimtari primare e po ashtu edhe në punët tjera sekondare nëse na ofrohen dhe kërkohet nga ne.

Pra vetë fakti i përpilimit të këtij dokumenti në formë të shkruar do të shërben për të pasur më shumë informata për menaxhmentin, Komisionin e Aksionareve dhe Bordin e Drejtorëve lidhur me afarizmin e ndërmarrjes duke analizuar informatat për vitin aktual dhe vitin e kaluar 2020.

Ky dokument përshkruan afarizmin vjetor të ndërmarrjes duke u bazuar në strategjinë e ndërmarrjes , dhe se qëllimi kryesor i këtij dokumenti është ofrimi i të gjitha informatave të rëndësishme, të cilat na shërbejnë për marrjen e vendimeve në ndërmarrje.

Monitorimi i këtij plani bëhet në vazhdimësi gjatë tërë vitit, dhe sipas nevojës mund të ndryshohet-revidohet nga menaxheri i ndërmarrjes me pëlqimin e Bordit të Drejtorëve.

I njëjti do të shërbejë për Bordin e Drejtorve, Komisionin e Aksionareve , Asamblenë Komunale dhe Menaxhmentin e ndërmarrjes si bazë për zhvillimin e ndërmarrjes dhe prioritetet që do ti ketë ndërmarrja në të ardhmen.

Ky plan i biznesit i cili është orientuar drejt menaxhimit të mirëfilltë të N.P.L. "Higjiena" Sh.A. në Deçan, ku për objektivat e përcaktuara me këtë plan janë dakorduar edhe Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes. Pasqyrat e politikave dhe synimet e përmbajtura brenda planit janë zhvilluar dhe aprovuar në Bordin e Drejtorëve, plani i biznesit do ti nënshtrohet rishikimit dhe freskimit në baza mujore.

Detyrë thelbësore e N. P. L "Higjiena" SH. A është që të ofroj shërbime për grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe heqjen e mbeturinave në territorin e komunës. Duke u bazuar në ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, ndërmarrja e mbeturinave është e limituar të kushtëzojë klientët të paguajnë për shërbimet për grumbullimin e mbeturinave, andaj presim nga Asambleja Komunale që të merr vendime adekuate në mënyrë që, N. P. K "Higjiena" SH. A. mund të mbulojë zbrazëtinë financiare.

N. P. L "Higjiena" SH. A. Në Deçan, do të jetë e vetë-qëndrueshme dhe do të arrijë mbulimin e plotë të kostos.. N. P. L "Higjiena" SH. A do të përkrahet financiarisht në përputhje me nenin 59 dhe 60 të Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L- 066 në mënyre që të kemi një ambient të pastër për një jetë sa më të shëndetshme për banoret e komunës.

## Aktivitetet e ndërmarrjes

Veprimtaria kryesore e NPK "Higjiena "SH. A në Deçan, është e përcaktuar në statutin e saj dhe përfshinë grumbullimin dhe barten e mbeturinave në komunën e Deçanit dhe klientë e saj, janë amvisëritë, bizneset dhe institucionet.

**Veprimtaria dhe aktivitetet e ndërmarrjes janë:**

- Veprimtaria dhe aktivitetet kryesorë: (3811)- Grumbullimi i Mbeturinave jo te rrezikshme
- Veprimtaria dhe aktivitetet dytësore : (3821)-Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo te rrezikshme.

Ndërmarrja Publike ka për qëllim në të ardhmen të merret edhe më këto veprimtari siç janë: riciklimin, kompostimin e mbeturinave.

**Aktivitet primare janë:**

- Menaxhimi i mbeturinave në territorin e komunës.
- Grumbullimi dhe trajtimi i tyre
- Riciklimi dhe kompostimi i mbeturinave në të ardhmen.

**Aktivitete sekondare janë:**

- Pastrimi i rrugëve
- Menaxhimi i varrezave dhe shërbimet e varrimit ;
- Mirëmbajtja e gjelbërimit dhe parqeve;
- Mirëmbajtja e hapësirave tjera publike
- Rregullimi (dekorimi) i qytetit për festa

Përvoja shumëvjeçare e ndërmarrjes tregon se kërkesat janë shumë të mëdha për shërbimet publike dhe me mjetet të konsiderueshme investime, kjo fushë veprimtari mund të jetë fitimprurësve. Aftësitë organizative edhe më tepërt vijnë në shprehje duke shfrytëzuar teknologjinë moderne për grumbullim, trajtimin, riciklim, kompostim të mbeturinave komunale gjithashtu duhet të theksohet edhe domosdoshmëria e digjitalizimit të sistemit për menaxhim të mbeturinave.

## Historiku

Në bazë të nenit 3.2 , 5.2 dhe 6.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike , dhe nenit 219 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtarë , të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 3 të Statusit të komunës së Deçanit, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të propozimeve të Komisionit Komunal të Aksionarëve të themeluar nga ana e Kuvendit komunal, dhe me rekomandim të Komitetit për Politika dhe Financa, njëzëri mori këtë : Vendim – për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale si pronë e Komunës e të cilën do ta menaxhoj menaxhmenti i ndërmarrjes.

NPL " Higjiena", Sh.A në Deçan, është ndërmarrje e specializuar dhe e licencuar në kryerjen e shërbimeve me rëndësi të vaçantë shoqërore për jetën e qytetarëve – bartjen e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e pastërtisë dhe higjienës publike. Rajoni ku shërben Ndërmarrja Publike Lokale „HIGJIENA" përfshin regjionin e Deçanit.

Ndëmarrja është në funksion që nga koha e paraluftës për të vazhduar edhe pasluftës bashkë me " Hidrodrinin" duke ofruar shërbime të ujit dhe

menaxhimit të mbeturinave deri në vitin 2006. Nga viti 2006 Ndërmarrja " Higjiena" ka filluar e vetëm shërbimet në menaxhimin e mbeturinave si një njësi operacionale në 100% e teritorit të komunës së Deçanit.

NPL " Higjiena" aktualisht ka një staf prej 40 punëtor funksionon me nje operativ në të gjitha fshatrat e komunës së Deçanit dhe ka një bashkëpunim të mirfillt dhe një pëkrahje të vazhdushme!

Misioni i NPL HIGJIENA SH.A është të menaxhoj me efiçiencë dhe përgjgjësi dhe të ofroj shërbime sa më të kënaqshme për konsumatorët dhe të përmush qëllimin e saj dhe të Komunës së Deçanit në këtë fushë, duke u mundësuar operativës të ofrojnë shërbime profesionale, konkurruese, të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin dhe në të njëjtën kohë promovimin e sektorit publik të menaxhimit të mbeturinave në komunë.

Qëllimet kryesore të NPL HIGJIENA SH.A bazohen në zhvillimin e kapaciteteve dhe sigurimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për konsumatorët, si dhe të avancoj sektorin e menaxhimit të mbetjeve me qëllim krijimin e kushteve për një mjedis të qëndrueshëm. Përmes krijimit dhe forcimit të bashkëpunimit në këtë sektor, qëllimi është të promovojë diskutimin dhe bashkëpunimin midis akterëve dhe institucioneve shtetërore për të përmirësuar situatën në sektorin e mjedisit duke forcuar kapacitetet e kompanisë që të operoj në sektorin e mbledhjes dhe trajtimit të mbetjeve. Ndër të tjera, bashkëpunimi midis ndërmarrjes dhe aktorëve institucionalë gjithashtu synon t'i ndërgjegjësojë qytetarët për rëndësinë e ruajtjes së një ambienti të pastër dhe të qëndrueshëm në komunë me një ndikim në cilësinë e jetës së qytetarëve të Deçanit.

Titulli i shkruar do të jetë: "N.P.L."HIGJIENA" SH.A. DEÇAN.

Ndërmarrja udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv i cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve , që është organi më i lartë në ndërmarrje në bazë të Ligjit mbi ndërmarrjet publike.

## Profili i komunës së Deçanit

Komuna e Deçanit shtrihet në pjesën jug-perëndimorë të Republikës së Kosovës gjegjësisht të Rrafshit të Dukagjinit. Qyteti është i ngritur rrëzë Bjeshkëve të Nëmura, që janë pjesë e masivit dinarike që përfshinë tërë Ballkanin perëndimorë. Nga pjesa perëndimore kufizohet më Republikën e Shqipërisë, në

veri-perëndim më Malin e Zi, në veri kufizohet më Komunën e Pejës, në veri-lindje me komunën e Junikut. Territori i Deçanit ka një sipërfaqe prej 297 $km^2$ ose 29.700 ha, me:

- *8613 ha- tokë bujqësore: 29%*
- *15444 ha -pyjore: 52%*
- *5643 ha kullosa: 19.%*

Brenda kufijve administrativ të Komunës së Deçanit ka 37 vendbanime (fshatrat), që janë të organizuara në 10 bashkësi lokale. Këto vendbanime karakterizohen me një infrastrukturë rrugore të asfaltuar me qarkullim të mirë rrugor.

Territori përbëhet nga: Ultësira, që është pjesa e rrafshit të Dukagjinit dhe në pjesën e lartësisë gjeografike - Bjeshkët Nëmura (Alpet Shqiptare). Kjo pjesë është e pasur me burime të shumta të ujit ku të gjithë lumenjtë, që përshkojnë territorin e Komunës, burojnë në lartësinë e "Bjeshkëve të Nemuna", të cilat derdhen në Drinin e Bardhe, që është ujëmbledhës dhe derdhen në Detin Adriatik.

Lumëbardhi i Deçanit buron në Bjeshkën e Roshkodolit në vendin e quajtur, "Tedel i Lumëbardhit" në lartësi 2130m, kurse Lumëbardhi i LLoqanit buron nga shpatijet e Kurvalles, Dervishë-Komit dhe të Stanishtes se Zogut në lartësi mbi detare 2100m.

Në lartësinë e bjeshkëve ekziston një numër madh i liqeneve me origjine glaciale të njohur në gjuhen popullore si "sytë e maleve". Këta liqe janë burimet kryesore të vlerave mjedisore, turistike dhe ekonomike për Komunën tone. Vlere të mëdha të këtij territori i shtone edhe "Gryka e Deçanit" me "Kanjonin e Lumëbardhit" të Deçanit, si dhe "Gryka e LLoqanit" të pasura me lloje të shumta të florë dhe faunë. Prej bimëve drunore ma të rëndësishmet në këto rajone janë: Gështenja (Castane Sativa), Hormoci (Picea), Bredhi (Abis), Arneni (Pinus Peuce), Arneni i bardhe (Pinus Cheldreichii), Ahu (Fagus moesiaca) dhe llojet e ndryshme të fletoreve. Në Gryken e Deçanit dhe Lloqanit është mjaft mirë e zhvilluar edhe verri (Alnus) dhe lloje të ndryshme të shelgut (salix).

Fauna e "Bjeshkëve të Deçanit" është e shumëllojshme me shume lloje që janë karakteristike të kësaj zone, siç janë: rrëqebulli, ariu i murrme (urgus actros), dhia egër (rupicapra rupicapra), ketri (scirflus vulgaris), derri i egër (sus strofa), ujku (canis lupus), macja e egër (fellis silverscis), kaprolli (caprelous), lepuri (lepus europaeus), etj.

Komuna e Deçanit ndahet në katër zona turistike: Zona turistike e qytetit të Deçanit më rrethinë; Zona turistike e Grykës së Deçanit: Bjeshka e Deçanit, e Roshkodolit, Pleqja, bjeshka e Baballoqit, e Belegut etj. Zona turistike e Grykës së LLoqanit, Zona turistike e Bjeshkëve të Strellcit.

Deçani ka klimë kontinentale me dimra të gjatë, në ultësira vërehet prania e ndikimit të klimës mediterane. Resurset e shumta natyrore si dhe vlerat trashëgimisë kulturore, i mundësojnë komunës së Deçanit zhvillim ekonomik, në veçanti zhvillimin e sektorit të turizmit dhe të bujqësisë.

*Fig. 1. Pozita e Deçanit në hartëm e Kosovës*



Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011 Deçani kishte një popullsi prej 40849 banorë, me 5887 ekonomi familjare, ku 95 % prej tyre janë shqiptar. Popullsia e komunës është e re ku 60% e popullsisë është nën moshën 15 vjeçare dhe vetëm 5% mbi moshën 65 vjeçare. Rreth 15% e popullsisë konsiderohet se jetojnë në varfëri të skajshme, ndërsa rreth 37% mund të konsiderohen si të varfër (Banka Botërore). Shkalla e papunësisë është përllogaritur dhe sillet prej 63 %. Nga numri i përgjithshëm i popullsisë së aftë për punë, janë punësuar vetëm 37 %. Pjesa prej 63 %, çdo ditë ballafaqohen me probleme themelore ekzistenciale, te cilat dita-ditës behën edhe më të rënda. Ekziston një migrim i banoreve nga fshati ne qendrën urbane dhe jashtë shtetit.

Tabela e mëposhtme tregon shpërndarjen e popullsisë në vendbanime.

*Tabela 1. Popullata sipas emërtimit të vendbanimeve*

| Nr. | Vendbanimi (emri) | Popullata (2011) |
|---|---|---|
| 1 | Deçan | 3803 |
| 2 | Carrabreg i Ultë | 2059 |
| 3 | Carrabreg I Epërm | 1446 |
| 4 | Llukë e Epërm | 1451 |
| 5 | Beleg | 826 |
| 6 | Prejlep | 2165 |
| 7 | Rastovic | 1238 |
| 8 | Voksh | 570 |
| 9 | Lloqan | 499 |
| 10 | Hulaj | 158 |
| 11 | Sllup | 338 |
| 12 | Pobergjë | 1314 |

| | | |
|---|---|---|
| 13 | Irzniq | 1739 |
| 14 | Kodrali | 808 |
| 15 | Pozhar | 424 |
| 16 | Llukë e Ultë | 506 |
| 17 | Lumbardh | 717 |
| 18 | Dashinoc | 299 |
| 19 | Vranoc i Vogël | 101 |
| 20 | Maznik | 447 |
| 21 | Ratish e Ultë | 560 |
| 22 | Ratish E Epërme | 210 |
| 23 | Gllogjan | 984 |
| 24 | Shaptej | 591 |
| 25 | Dubrav | 278 |
| 25 | Gramaqel | 1097 |
| 26 | Baballoq | 1598 |
| 27 | Prokolluk | 288 |
| 28 | Strellci Eperm | 3347 |
| 29 | Strellc i Ultë | 2114 |
| 30 | Lëbushe | 1045 |
| 31 | Belle | 8 |

| | | |
|---|---|---|
| 32 | Isniq | 3071 |
| 33 | Prapaqan | 740 |
| 34 | Dubovik | 1060 |
| 35 | Papiq | 174 |
| 36 | Jasiqi i Ri | 100 |
| 37 | Dranoc | 1046 |
| Totali | | 40849 |

Sektori i industrisë është i dëmtuar që nga lufta dhe i njëjti nuk është në funksion. Pjesa më e madhe e fabrikave të dikurshme si: Fabrika auto-pjesëve "Ramiz Sadiku" ne Isniq, e pompave me piston në Isniq, rrjetit të armiruare në Deçan, përpunimit të mjaltit "APIKO" në Deçan, fabrikat për përpunimin e drurit, mobileve po të funksiononin do të kishin efekt pozitiv në uljen e papunësisë. Disa nga këto objekte janë privatizuar sipas AKM-ës dhe funksionojnë shume pak, duke mos ndikuar pothuajse aspak në uljen e papunësisë. Sipas Planit Zhvillimor Komunal, parku industrial është i parapare në hyrje të qytetit të Deçanit nga magjistralja Pejë-Deçan në pjesën e majtë, ndërsa kategoria e tokës III-të, sipas Planit hapësinor të Kosovës parashihet industri e lehte.

**Ekonomi biznesore në komunë - gjithsej** janë 2282 prej tyre aktive janë **970**. Struktura e mëtejshme e biznesit në Deçan është si më poshtë:

- Tregti 397 subjekte
- Shërbime Hoteliere 190 subjekte (hotele, furnizim ushqimi, kafiteri / bare, etj)
- Prodhuese 140 subjekte
- Transport 55 biznese me një total prej mbi 100 kamionë të ndryshëm për transport
- Ndërtimtari 30 subjekte
- Transport mallrash 50 subjekte
- Shërbime 21 subjekte

- Zejtari 87 subjektet

Gjithashtu ka disa sipërmarrës joformal, të paregjistruara si elektricistë, kompani ndërtimore, frizer, rrobaqepës etj. Institucionet brenda komunës përfshijnë:

| | Institucione publike në komunë – gjithsej | Ndërtesa |
|---|---|---|
| 1 | Ndërtesa e komunës | 3 |
| 2 | Shkolla fillore, të mesme | 21 |
| 2 | Biblioteka | 2 |
| 3 | Shtëpi të shëndetit, QKMF | 12 |
| 4 | Bashkësi lokale | 10 |
| 5 | Shtëpi të kulturës, qendra rinore, teatro | 2 |
| 6 | Institucione parashkollore | 1 |
| 7 | Stacioni i zjarrfikësve | 1 |
| 8 | Posta | 1 |
| 9 | Qendra për Punë Sociale | 1 |
| 10 | Qendra e Regjistrimit Civil | 1 |
| 11 | Stacioni Policor | 1 |
| 12 | Totali | Gjithsej institucione 56 |

*Tabela 2. Institucionet publike në Komunë*

## ASETET E NDËRMARRJES

| Nr. | Mjetet | Tipi | Sasia | Gjendja | Kapaciteti punues |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kamion | Man | 2 | E mirë | Për zbrazjen e kontejnerëve 1.1 $m^3$ dhe 120 L. |
| 2. | Kamion- Me rimorkio | Man | 1 | E mirë | Për zbrazje( ngarkim, shkarkim) |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3. | Kamion | Mercedes | 2 | E mirë | Për zbrazjen e kontejnerëve 1.1m dhe 120 L |
| 4. | Kamion | Volvo | 2 | E mirë | Për zbrazjen e kontejnerëve 1.1m dhe 120 L |
| 5. | Kamion | Iveko | 1 | E mirë | Për zbrazjen e kontejnerëve 1.1 m |
| 6. | Kamion | Scania | 1 | E mirë | Për zbrazjen e kontejnerëve 1.1 $m^3$ |
| | Kamion | MAN | 1 | E mirë | Multi funksional per ujera te zeza |
| | Kamionetë | Ford | 1 | E mirë | Me rimorkio per bartjen e mbeturinave |
| 7. | Eskavator | Benfar | 1 | E mirë | Për eliminimin e deponive ilegale si dhe kryerjen e punëve tjera të nevojshme. |
| 8. | Traktor | Tigar 35 | 1 | E mirë | Për grumbulllim të mbeturinave tek pjesët e ndryshme që nuk mund të kryejë shërbim kamioni |
| 9. | Krani | Nisan | 1 | E mirë | Për ndërrimin dhe vendosjen e flamujve, dekorimin e qytetit si dhe shërbime tjera të nevojshme. |
| | Pikap | Peguot 2007 | 1 | E mirë | |
| | Veturë | Polo | 2 | E mirë | |
| 10 | Kontejnerë 1.1 $m^3$ | | 200 | Jo aq e mirë | |
| 11 | Kontejnerë 12-14 $m^3$ | | 9 | Jo aq e mirë | |
| 12 | Kontejnerë | | 3 | Jo aq mirë | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | $7m^3$ | | | | |

*Tabela 3. Asetet e luajtëshme të ndërmarrjes*

## Sasia dhe përbërja e mbeturinave

Bazuar në të dhënat e gjenerimit të vjetor të mbeturinave për person në komunë është vlerësuar të jetë 219 kg/person. Me 40849 banorë të përhershëm, gjenerimi vjetor i mbeturinave të amvisërisë mund të vlerësohet të jetë rreth 8298 ton.

Mbeturinat e ngurta komunale përfshijnë mbeturinat komerciale krahas mbeturinave të amvisërisë. Një supozim është se mbeturinat e amvisërisë përbëjnë vetëm 70% -75% të totalit të mbeturinave të ngurta komunale.Përafërsisht 1733 ton të mbeturinave të amvisërisë në vit, janë deri në 800 ton mbeturina komerciale që pritet që të gjenerohen.

Përveç të dhënave të grumbulluara gjatë marrjes së informacionit mbi sasinë e mbeturinave të dërguara në deponin regjionale Sverk të Thatë ky informacion tregon se rreth 1733 ton mbeturina në vit grumbullohen në Deçan. Edhe pse, shërbimet e grumbullimit të mbeturinave ofrohen tek shumica e gjeneruesve të mbeturinave, disa fshatra[1] nuk marrin fare shërbime të grumbullimit të mbeturinave. 1733 ton të mbeturinave të mbledhura në një bazë vjetore përfaqëson rreth 70% të mbeturinave të gjeneruara. Kjo do të tregonte një gjenerim vjetor të mbeturinave prej 1733 ton.

Për qëllime të planifikimit, bazuar në ato që u than më sipër, do të supozohet se do të gjenerohen nga 2000 deri në 3500 ton mbeturina të ngurta komunale në vit. Përveç mbeturinave shtëpiake dhe komerciale, po ashtu gjenerohen mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimet në Deçan. Informacioni i besueshëm nuk është në dispozicion, por vëzhgimet e bëra në deponin komunale, ku mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit

[1] Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave nuk janë në dispozicion në 22 fshatra me respektivisht 4416 amvisëri.

përdoren për ngritjen e terrenit si përgatitjet për realizimin e një parku, tregojnë se norma e gjenerimit mund të jetë prej disa në qindra ton në vit.

Komuna e Deçanit nuk ka industri të zhvilluar edhe ato që janë, është industri e lehta (druri), mbetjet industriale praktikisht nuk gjenerohen. Si përmbledhje, mund të paraqitet tabela e mëposhtme:

| Lloji i mbeturinave | Gjenerimi i sasisë së mbeturinave (vlerësim) |
|---|---|
| Mbeturinat shtëpiake | **8200 ton/vit** |
| Mbeturinat komerciale | **3300 ton/vit** |
| Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi | 3000- 4500 ton/vit |
| Mbeturinat industriale | 15 ton në viti<br>duke përfshirë mbeturina nga rrënimi- betonarmeja, druri etj. |

*Tabela 3. Lloji dhe sasia e mbeturinave*

## Përbërja e mbeturinave

Tabela janë dhënë përbërja e mbeturinave në komunën e Deçanit në kategori të përcaktuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe krahasua me përqindjet e të dhënave në Kosovë të raportuara në "Situatën e tanishme të mbeturinave në Kosovë ", publikuar nga Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit.

| Përbërja e mbeturinave të amvisërisë në Kosovë dhe Deçan |
|---|

| Ndarja e mbeturinave | Kosovë | Komuna e Deçanit |
|---|---|---|
| Organike (mbeturinat e kuzhinës dhe kopshtit) | 35.3% | 35.8% |
| Çelçi | 21% | 11.8% |
| Druri | 11% | 14.2% |
| Plastika | 9.4% | 9.4% |
| Metalet | 9.3% | 11.1% |
| Tekstilet | 8.2% | 13.5% |
| Letër dhe karton | 4.6% | 4.1% |
| Mbeturinat e rrezikshme shtëpiake | 1.2% | 0.1% |
| | 100% | 100% |

*Tabela 4. Përbërja e mbeturinave të anvisërisë në Deçan*

Duke i krahasuar me mbeturinat e amvisërisë, mbeturinat komerciale do të përmbajnë përqindje më të lartë të materialeve të paketimit dhe në këtë mënyrë përqindje më të lartë të letrës, kartonit dhe plastikes. Përveç kësaj, mbeturinat komerciale përmbajnë mbeturina (nën-produkte të kafshëve) nga thertoret. Përbërja e mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi nuk është hulumtuar. Vëzhgimet në deponi megjithatë tregojnë se pjesa më e madhe e mbeturinave janë: betoni, dhe, tullat e rrënojës së shtëpive.

## Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave dhe forma e deponimit

Shërbimet aktuale të menaxhimit të mbeturinave, siç u përmend në fillim, ofrohen nga ndërmarrjen"Higjiena". Ndërmarrja është ndërmarrje publike dhe është e kontraktuar nga Komuna për të ofruar shërbime. Kompania ka 49 punonjës me orar të plotë që përfshijnë:

| Nr. | Pozita | |
|---|---|---|
| 1 | Kryeshef Ezekutiv | 1 |
| 2 | ZKF | 1 |
| 3 | Menaxher Operativ | 1 |
| 4 | Menaxher për Burime Njerëzore | 1 |
| 5 | Zyrtar/Ligjor | 1 |
| 6 | Zyrtar/Prokurimi | 1 |
| 7 | Kontabilist | 1 |
| 8 | Inspektor | 1 |
| 9 | Faturist | 1 |
| 10 | Arkatar | 1 |
| 11 | Furnitor | 1 |
| 12 | Depoist | 1 |
| 13 | Portoark | 1 |
| 14 | Koordinator Operativ | 1 |
| 15 | Kryepunëtor për Amvisëri | 1 |
| 16 | Kryepunetor për Oaza | 1 |
| 17 | Vozitës | 10 |
| 18 | Inkasant | 5 |
| 19 | Punëor Operativ | 16 |
| 20 | Recepcioniste | 1 |
| 21 | Roje | 3 |

*Tabela 5. Numri dhe struktura e stafit*

Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave ofrohen për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave në komunë. Në qendrën e qytetit, për çdo ditë kryhet shërbimi, ndërsa në zonat tjera të banimit, shërbimi kryhet një here në javë. Shërbimi, në pjesën urbane kryhet gjatë shtatë ditëve të javës.

Të gjitha amvisëritë janë pajisur me një kontejner me rrota të mbeturinave prej 120 litra ndërsa bizneset dhe institucionet janë të pajisur me kontejner 120 litra dhe me 1.1 $m^3$ .

Mbeturinat e mbledhura transportohen në deponin regjionale në Sverk të Thatë 27 km larg nga Deçani, transportit në deponi është i preferuar sepse shkarkimi i lehte dhe i menjëhershëm i mbeturinave është i garantuar. Përveç grumbullimit të mbeturinave, kompania ofron shërbimin për pastrimin e rrugëve dhe parqeve dhe, sipas nevojës, ofron shërbimet për dekorim të qytetit për festat zyrtare. Ndërmarrja sipas kontratës ka afruar shërbim institucioneve publike dhe amvisërive më këto tarifa:

- **Pastrimi i rrugëve dhe trotuareve 0,002 € për $m^2$**
- **Mirëmbajta e parkut dhe hapësirave përreth objekteve publike0,003 €për $m^2$**
- **Pastrimi i kontejnerëve 1.1 $m^3$ – 12.10€ për një zbrazje**
- **Pastrimi i kontejnerëve 12$m^3$ -36€ për një zbrazje**
- **Pastrimi i kontejnerëve 14$m^3$ -€ për një zbrazje**
- **Dekorimi i qyteti € për punëtor**

Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi menaxhohen nga vet gjeneruesit e mbeturinave por edhe deponohen në deponin komunale. Me rimorkio të kamionit ose traktorit, gjeneruesit e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit transportojnë mbeturinave në një deponi në fshatin Lëbushë përgjatë rrugës regjionale Pejë-Deçan. Aty mbeturinat përdoren për të mbushur gropat e erozionit të Prronit të Behovcit si përgatitje për realizimin e një tregu regjional për kafshë. Mbikëqyrja e deponisë është shumë e kufizuar dhe herë pas here deponohen edhe mbeturina tjera përveç atyre të ndërtimit dhe rrënimit. Për më tepër, për shkak të mungesës së mbikëqyrjes, nuk verifikohet cilësia dhe pranueshëmëria e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit.

Mbeturinat e përziera të krahasueshme me ato të amvisërisë transportohen në deponinë e regjionale ndërsa pjesët e ndara riciklohen si letra, alumini.

Si përmbledhje, mund të paraqitet tabela treguese në vijim me metodat e deponimit:

| Lloji i mbeturinave | Sasia (t/vit) | Metoda e deponimit |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| Mbeturinat e amvisërisë | 8298 | Hidhen në deponi regjionale |
| Mbeturinat komerciale | 1500 | Hidhen në deponi regjionale |
| Mbeturinat e ndërtimit | 2000-3500 | Hidhen në deponi në komunë |
| Mbeturinat industriale | 15 | Hidhen ose shiten jashtë komunës pikat e grumbullimit |

*Tabela 6. Lloji i mbeturinave dhe metoda e deponimit*

## Aspekti organizativ dhe financiar i menaxhimit të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave është përgjegjësi e ndërmarrjes "Higjiena". U përmend edhe më lart se për ofrimin e shërbimeve për grumbullim të mbeturinave, komuna ka bërë kontratë me ndërmarrjen publike "Higjiena" , për grumbullimi të mbeturinave dhe mirëmbajte/pastrim të rrugëve dhe trotuareve në mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe kontejnerëve. Ndërmarrja ka ofruar 1471 kontejnerë për të gjithë ekonomit familjare (për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave); Tarifat aktuale janë:

- Pastrimi i rrugëve dhe trotuareve 0,002 €për $m^2$
- Mirëmbajta e parkut dhe hapësirave përreth objekteve publike0,003 €për $m^2$
- Pastrimi i kontejnerëve 1.1 $m^3$ -8.05€ për një zbrazje
- Pastrimi i kontejnerëve 12$m^3$ -120€ për një zbrazje
- Pastrimi i kontejnerëve 14$m^3$ -140€ për një zbrazje
- Dekorimi i qytetit-20 € për punëtor

Përveç kësaj, komuna paguan për mbeturinat e krijuara në shkollat, në stacionin e zjarrfikësve, shtëpia e kulturës dhe mbeturinat nga qendrat mjekësore. Për deponimin e mbeturinave të grumbulluara në deponinë e regjionale, kompania për deponim të mbeturinave paguan një tarifë prej 6 € për ton.

| Nr. | Numri i banorëve në komunë | Sasia e mbeturinave për kokë | Mbeturina të deponuar në vit | Vlera për ton/€ |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 40849 | 17 kg | 8298 ton | 4.0 € |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2 | **Totali** | | | 33,192.00€ |

*Tabela 7. Mbeturinat për kokë banori*

## Plani Operativ

| Orari për grumbullimin e mbeturinave | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **E HËNË** | **E MARTË** | **E MËRKURE** | **E ENJTE** | **E PREMTE** | **E SHTUNË** | **E DIEL** |
| UNAZA | UNAZA | UNAZA | UNAZA | UNAZA | UNAZA | UNAZA |
| INSTITUCIONET | LEDINAT | POLANA | INSTITUCIONET | LËBUSHË | | |
| DEÇANI | CARRABREG I ULËT | POBËRGJË | RATISH I EPËRM | STRELLC I EPËRM | | |
| ISNIQI | CARRABREG I EPËRM | HULAJ | RATISH I ULËT | STRELLC I ULËT | | |
| | PRILEP | LOQAN | DASHINOC | DUBOVIK | | |
| | RASTAVICË | VOKSH | MAZNIK | PRAPAQAN | | |
| | | DRENOC | VRANOC I VOGËL | PAPIQ | | |
| | | SLLUP | LLUKË E EPËRME | BABALLOQ | | |
| | | IRZNIQ | BELEG | GRAMAQEL | | |
| | | PREKOLLUK | POZHAR | | | |
| | | GLLOGJAN | KODRALI | | | |
| | | SHAPTEJ | LUMBARDH | | | |
| | | DUBRAVË | LLUKË E ULËT | | | |
| Vërejtje: Banorët e fshatrave të lartecekura, në ditët e caktuara, kontejnerët, apo qeset me mbeturina, i vendosin jashtë oborreve (para dyerve) | | | | | | |

## Analiza e Tregut

N.P.L "Higjiena" është Ndërmarrje Publike dhe është e vetmja në komunën e Deçanit e cila bene grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave ne deponi.

**Analiza SWOT**

Analiza e mëposhtme paraqet vlerësimin aktual të ndërmarrjes në aspektin e menaxhimit dhe ofrimin e shërbimeve.

**SËOT Analiza**

| Perparsit | Dobesitë |
|---|---|
| • I vetmi në këtë fushë të shërbimeve në Deçan;<br>• Licencimi;<br>• Menaxhment me përvojë;<br>• Shërbime kualitative;<br>• Rritje e vazhdushme e numrit te klienteve<br>• Objekti i ri Administrativ etj.<br>• Standartizim i ofrimit te kushteve ne departamentin e operatives.<br>• Konsulidimi i sistemit funksional te ndermarrjes.<br>• Shtrirja e sherbimeve ne zonat rurale.<br>• Blerja e makinerive(shtimi kapaciteteve) | • Makineritë e vjetërsuara;<br>• Stafit në moshë mbi mesatare;<br>• Kualifikimet dhe edukimi i vazhdueshëm joformal, |
| **Mundësitë** | **Rreziqet** |
| • Zgjerimi i sherbimeve në pjesën malore- në Bjeshkët e Deçanit<br>• Rritja e stafit<br>• Shtim i aktiviteteve per pastrim te objekteve jashte dhe brenda<br>• Ndarja e mbeturinave | • Mos zbatimi i politikave dhe planeve strategjike nacionale per mbetruina;<br>• Mos Arketim i llogarive te arkëtueshme<br>• Kontestet e trashëguara;<br>• Mungesa e përkrahjes së duhur nga Inspektorati Komunal |

- Kategorizimi jo i mire i bizneseve etj.
- Situatat e paparashikuara shendetsore-natyrore (COVID-19)

## Përparsit

**I vetmi në këtë fushë të shërbimeve në Deçan;** Kjo është njëra ndër përparësitë me te medhaje te ndermarrjes sepse është e vetmja në Deçan, çka nënkupton se nuk duhet t'i frikësohemi konkurrencës. Kjo nuk do të thotë se do të ketë ndonjë neglizhencë, përkundrazi do të shtohet përgjegjësia duke u rritur vëmendja ndaj operatorëve dhe përsonelit për të ngritur cilësinë e shërbimeve që ne ofrojmë.

**Licencimi;** Licencimi është nje dokument shume i nevojshëm për funksionimin e ndërmarrjes tonë dhe domosdoshmërish duhet ta kemi, dhe kujdesemi qe çdo herë te vazhdohet afati i licencë.

**Menaxhment me përvojë;** Stafi menaxherial është një staf i kualifikuar dhe me provoj te madhe ne menaxhimin e mbeturinave, dhe planifikimin sa me te mire planeve operative për mbajtjen e një ambienti te pastër ne qytetin e Deçanit.

**Shërbime kualitative;** Synim i ndërmarrjes tone është kualiteti i shërbimit te cilin e ofrojmë, duke synuar rritjen e numrit te shërbimeve.

**Rritje e vazhdushme e numrit te klienteve;** Duke pasur parasysh zgjerimin e vazhdueshëm te qytetit e shohim si një përparësi te rritjes se numrit te klientëve, evidentimin e tyre dhe kujdesin e duhur ndaj tyre.

**Objekti i ri;** Ndërmarrja operon ne një objekt te ri administrativ e cila e lehtëson punën e stafit dhe ndikon ne kualitetin e stafit.

Standardizim i ofrimit te kushteve ne departamentin e operatives: nënkupton mundesin e ofrimit te sherbimit ne menyre me efikase.

Konsulidimi i sistemit funksional te ndermarrjes: nenkupton harmonizimin e skemës organizative te mbeshtetura ne ligjet dhe rregulloret e brendshme.

**Ndarja e mbeturinave:** Kompania synon gjatë vitit 2023 të fillojë ndarjen e mbeturinave.

## Dobesitë

**Makineritë te vjetërsuar;** Ndërmarrja rrezikohet nga mos kryerja e shërbimit për shkak te vjetërsisë se aseteve, te cilat janë shume te nevojshme për realizimin e shërbimeve.

**75 % e stafit në moshë mbi mesatare;** për shkak te ndryshimit teknologjik do duhet te kemi trajnime shtesë per ketë kategori te punësuarve.

## Mundësitë

**Zgjerim i shërbimeve;** synimi i ndërmarrjes është qe te beje zgjerimin shërbimit në Bjeshkët e Deçanit si dhe lloj llojshmërish se shërbimeve te kontraktuar nga komuna ( Gjelbërimi i hapësirave publike, pastrimi i rrugëve publike dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik).

**Rritja e stafit;** me zgjerimin e shërbimeve do te shfaqet nevoja për rritje te stafit.

Shtim i aktiviteteve për pastrim te objekteve jashtë dhe brenda: nënkupton ofrimin e një shërbimi te ri përmes se cilit ndërmarrja do te krijonte marrëveshje me institucione publike dhe biznese private për pastrimin gjeneral te objekteve.

## Rreziqet

**Mos zbatimi i politikave dhe planeve strategjike nacionale për mbeturina;** Ekzistojnë mungesë e zbatimit te politikave për ndërmarrjen tone jo vetëm ne rajon po në te gjithë territorin e Republikës se Kosovës.

**Mos arkëtim i llogarive te arkëtueshme;** Parashihet rreziku i krijimit te burgjeve te mëdha të cilat ndërmarrja nuk mund qe ti arkëtoj pa ndihmen e përmbaruesve privat dhe duhet te behet një ndryshim ne planin strategjik te mbledhjes se burgjeve.

Situatat e paparashikuara shëndetësore-natyrore (COVID-19):rreziku nga COVID 19 mbetet një nga sfidat e ndërmarrjes edhe per vitit 2022, sepse pamundëson funksionimin normal te ndërmarrjes duke pasur implikim direkt ne zvogëlimin e inkasimit, rrjedhimisht ndikon edhe ne likuiditetin e ndërmarrjes.

## Strategjia e Marketingut

Një hap përpara për Kompaninë tonë është të organizojmë fushata efektive të vetëdijesimit të publikut të përqendruara në:

- Ngritjen e vetëdijes së qytetareve nëpërmjet formave të ndryshme te thirrjes se tyre për ti realizuar pagesat;
- Inkurajimin dhe motivimin e klientëve për të paguar për shërbimet e mbledhjes dhe deponimit te mbeturinave
- Dhënien e mesazheve të mirëfillta nëpërmjet mjeteve elektronike dhe të shkruara .

Kompania po ashtu e përkrah idenë e kampanjës publike në nivel nacional me të gjitha palët e involvuara në menaxhimin e mbeturinave për të rritë vetëdijen e qytetareve per pagesën e tyre.

## Menaxhmenti

Në bazë të nenit 16 dhe 21 të ligjit nr. 03/L-087 Mbi Ndërmarrjet Publike dhe Statutit të N.P.L. "Higjiena"Sh.A. në Deçan, Ndërmarrja Higjiena menaxhohet nga Kryeshefi Ekzekutiv, dhe mbikëqyret nga Bordi i Drejtorëve.

Struktura Organizative është e bashkangjitur në pjesën e shtojcave.

# Qëllimet dhe Objektivat

Qëllimi i N. P. L "Higjiena" SH. A., është angazhimi për mbulimin e tërë territorit të komunës me shërbime për grumbullim, pastrim, dergim të mbeturinave në deponin regjionale. Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve me institucionet komunale, me qëllimin e përbashkët për të ruajtur dhe mbajtur pastër ambientin në pjesën urbane dhe rurale. Angazhimi i përbashkët i institucioneve komunale relevante, do të ndikoj në ndalimin e hedhjes se mbeturinave në hapësirat publike përgjatë rrugëve, afër shkollave, fshatrave, lumenjve etj. Pra, në përgjithësi janë këto qëllime që duhet të arrihen:

- Ofrimi i shërbimeve me të mira në operimin dhe deponimin e mbeturinave
- Mbrojtja e mjedisit.

- Menaxhimi i deponisë drejt vetë-qëndrueshmërisë financiare (të shihet mundësia e ndarjes së deponisë si Njësi e veçantë ne kuadër te ndërmarrjes për faktin se ekziston mundësia e ndërtimit te një deponie te re nga donatorët e jashtëm).
- Rritja e numrit te aseteve operuese ( Kamjoneve te ri) te ndërmarrjes.
- Zvogëlimi i shpenzimeve operative.
- Rritja e shkallës së inkasimit.
- Digjitalizimi i klientëve
- Trajnimi i punëtorëve.
- Përmirësimi i sistemit të operimit të deponisë.
- Organizimi i detyrave dhe orarit të punës për punëtore si dhe menaxhimi i cilësisë .
- Tarifat e qëndrueshme për shërbimet e ofruara.
- Vetëdijesimi i qytetareve ndaj perkujdesjes se mjedisit.
- Aplikimi ne grante dhe subvencione
- Zvogëlimi i llogarive të arketueshme
- Aplikimi i kontratave me të gjitha bizneset dhe klient privat;
- Kontakti me përfaqësues të fshatrave lidhur me ofrimin e shërbimeve tona;
- Zvogëlimi i shpenzimeve operative;
- Zgjerimi i aktiviteteve në fshatrat e komunës tonë;
- Riorganizimi i vendeve të punës dhe numrit të punëtorëve;
- Digjitalizimi i sistemit për grumbullimin e mbeturinave-ekonomive familjare, bizneseve, institucioneve publike
- Aplikimi i një sistemi të avancuar të kontabilitetit dhe kontrollit financiar të cilat janë të domosdoshme për zhvillimin e veprimtarisë.
- Zvogëlimi i shpenzimeve operative
- Futja e partneritetit privato-publik
- Riciklimi dhe kompostimi i mbeturinave

## Vizioni

Vizioni i ynë është që duke operuar financiarisht të pavarur të zgjerojmë dhe të rrisim  nivelin e ofrimit të shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave në pjesën urbane-qytet dhe në zonat rurale, për të siguruar ambient të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë qytetarët dhe bizneset në territorin e komunës tonë. Qëllimet strategjike për përmbushur vizionin janë:

- Ofrimin e shërbimeve më të mira për grumbullim të mbeturinave
- Menaxhimin e ndërmarrjes në mënyrë që të arrijë vetë-qëndrueshmërinë financiare.
- Zvogëlimi i shpenzimeve të operimit
- Ngritja e përqindjes së faturimit dhe inkasimit
- Mirëmbajtja automjeteve dhe modernizimi i tyre.
- Digjitalizimit të sistemit të menaxhimit të mbeturinave

HIGJIENA SH.A. është partner i qytetarve dhe komunës për ambientin të pastër dhe shtyllë e zhvillimit të qëndrueshëm!

## Misioni

Misioni i ndërmarrjes është që ti mbuloi të gjithë territorin e komunës me shërbimet pa dallim race, religjioni apo kombësie për të siguruar një kompani financiare të vetë-qëndrueshme dhe afatgjatë  që mund të siguroi shërbime në pajtim me standardet për administrim të mbeturinave të përcaktuara me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Misioni i kompanisë është, përmirësimi i shërbimeve ne pajtim me standardet ndërkombëtare, rritja e pjesëmarrjes në treg, përmirësimi i pozitës tekniko financiare dhe qëndrueshmëri afatgjate financiare.

Më qëllim të përmbushjes së misionit të ndërmarrjes, synojmë:

- Pastrimin dhe grumbullimin e mbeturinave në qytetin e Deçanit
- Pastrim dhe grumbullimin e mbeturinave në pjesët rurale
- Pastrim dhe grumbullimin e mbeturinave në Bjeshkët e Deçanit
- Mbartja mbeturinave në deponinë regjionale
- Pastrim dhe mirëmbajtje të qytetit, parqeve dhe rrugëve
- Zgjerimi i veprimtarisë më aktivitete e riciklimit, kompostimit në interes të rritjes së hyrave në ndërmarrje
- Digjitalizimi i shërbimeve.

Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena”, për menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave do të ofroj shërbime me qëllim të mirëmbajtjes së ambientit ku punojmë dhe jetojmë sepse pa një ambient të shëndetshëm nuk do të kemi popullatë të shëndetshme me një të ardhshme të ndritshme.

Rruga drejtë suksesit për ndërmarrjen tonë eshtë krijimi i një identiteti gjithnjë duke i'a atribuar rritjes së cilësisë së shërbimeve tona. Pra, cilësia është ajo që na përcakton, ajo do të na çojë drejtë suksesit.

Duke krijuar një lidhje të fortë me Operatorët vendorë dhe të huaj nga e gjithë Evropa, ne synojmë zgjerimin e këtyre kontratave dhe krijimin e një hapësire më të madhe të kërkesës dhe ofertës në veprimtarinë tonë.

Me kapacitetet aktuale të krijuara, qëllimi ynë është që të kemi shërbimet më të mira sipas standardëve.

## Indikatorët e performancës

SHKALLA E TË HYRAVE TË FATURUARA:/MBULIMI ME SHËRBIME PËR KONSUMATORET E REGJISTRUAR : vlera e shërbimeve ndaj të hyrave të faturuara nga të gjithë kategoritë e klientëve, apo numri i konsumatorëve aktual në data bazë i ndarë për numrin e konsumatorëve të planifikuar për një vit.

SHKALLA E FATURIMIT/PERQINDJA E FATURIMT: numri i klientëve të faturuar ndaj numrit të klientëve të shërbyer, apo numri i faturave të lëshuara në raport me konsumatorët e regjistruar në data bazë.

SHKALLA E TË HYRAVE TË INKASUARA: të hyrat e inkasuar ndaj të hyrave të faturuara nga të gjitha kategoritë e klientëve.

SHKALLA E INKASIMIT / SHKALLA E ARKËTIMIT: numri i klientëve që paguajnë faturat ndaj numrit të klientëve të faturuar, apo shuma e arkëtuar ndarë për shumën e faturuar.

SHKALLA E OPERIMIT 2/ NORMA E MBULIMIT TE PUNËS : Të hyrat e inkasuar ndaj kostos së operimit duke përfshi edhe investimet.

BORGJET E KËQIJA- MUAJT E DEBITOREVE: Kontot e farkëtueshme të ndarë për shumën e faturuar për muaj.

INDEKSI I EFIKASITETIT OPERUES/ EFIKASITETI I STAFIT: Numri i punëtorëve për 1000 klient të faturuar, apo numri total i stafit i shprehur në 1000 pika faturuese.

## Monitorimi

Ndërmarrja jonë ka përgatitur disa tregues financiar për të pasqyruar rrjedhën e të hyrave, faturimit, inkasimit etj. Të gjitha këto shabllonë do të përdoren në të ardhmen për të përcjellë progresin mujor, tremujor dhe vjetor dhe rrjedhën e zhvillimeve të përformimeve financiare të ndërmarrjes.

Në fushën e monitorimit të punëtorëve, prioritet do të ketë forcimi i disiplinës së punës. Punëtorët do ti raportojnë për çdo dite eprorit të tij me të lartë duke e respektuar hierarkinë e strukturës organizative. Këto raporte mbi angazhimet ditore do të jenë të përcjellë dhe do të jenë kritere për vlerësimin e rezultateve të punës, dhe mos tregimi i rezultateve do të bien në pyetje se a do të ju vazhdohet kontrata apo jo. Çdo gjashtë muaj do të bëhet evoluimi i rezultateve të punës duke filluar nga stafi menaxhues e deri te stafi ndihmës.

Në vitin 2021 janë të mbuluara të gjitha zonat urbane dhe rurale. Në bazë të hulumtimeve del që kanë deklaruar që nuk mbulohen nga shërbimet, por ka të ngjarë të jenë individ të cilët kanë rezistuar. Në vitin 2022 NPL "Higjiena" sh.a do të bejë përpjekje të përfshijë të gjithë qytetarët, duke përmirësuar linjat e grumbullimit.

## Shërbimet për grumbullimin e mbeturinave

Komuna ka zgjeruar grumbullimin e mbeturinave nga niveli 70% e grumbullimit të mbeturinave në 100% të gjithë gjeneruesve të mbeturinave, Komuna e Deçanit ka për qëllim që të rris efikasitetin e pajisjeve të grumbullimit të mbeturinave.

Përmes Ndërmarrjes së Re Publike komuna, planifikon të ofrojë këtë shërbim me automjetin/asetet e tanishëm që posedon për grumbullimin e mbeturinave. Por duhet theksuar se Komuna e Deçanit synon që të prokurojë një automjet të ri kamion mikser ne gjendje te mire për grumbullimin e mbeturinave. Në atë rast automjeti i vjetër do të largohet nga shërbimi apo grumbullimi i mbeturinave për shkak të dëmtimit të rezervuarit të mbeturinave apo riparimi i tij kushton dhe për këtë arsye nuk do të përdoret. Orari i grumbullimit të mbeturinave do të përcaktohet nga Departamenti i Shërbimit Publik në konsultim me Ndërmarrjen e Publike të mbeturinave publike. Paraprakisht, paraqitet orari i mëposhtëm.

| Zonat – vendbanimet | Planifikimi i ditëve |
|---|---|
| Qyteti i Deçanit | 365 |
| Pjesa rurale | 250 |
| **Gjithsej 615** | **Ditë të planifikuara 615** |

*Tabela 8. Plani i grumbullimit sipas llojit të vendbanimeve*

# Qasja për rritjen dhe mbajtjen e shkallës së synuar në treg

## Marrëdhënjet me klient

Gjate vitit 2022 do ketë këto aksione me klient:

- Pranimi i kërkesave të drejtpërdrejta apo telefonike për intervenim në pastrim
- Kontakti me përfaqësues të lagjeve për bashkëpunim
- Identifikimi i klientëve të rinj
- Mesazhe për konsumator mes mjeteve të informimit dhe
- Kontakti me përfaqësues të fshatrave për bashkëpunim, lidhur me ofrimin e shërbimeve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave

## Vetëdijësimi i popullatës

Një hap përpara për ndërmarrjen është organizimi i fushatave efektive të vetëdijesimit të popullatës, të përqendruara në:

- Ngritjen e vetëdijes së popullatës nëpërmjet të shërbimit më të mirë të mbledhjes së mbeturinave;
- Inkurajimin dhe motivimin e klientëve për të paguar për shërbimet e mbledhjes së mbeturinave;
- Dhënien e mesazheve të mirëfillta nëpërmjet kombinimit të duhur të mjeteve komunikuese.

Ne po ashtu përkrahim idenë për një kampanjë në nivel nacional, të organizuar nga të gjitha ndërmarrjet e Kosovës për rritjen e vetëdijesimit të qytetareve. Fushata sensibilizues do të zhvillohet me këto aktivitetet :

a) Takime me qytetar nëpër vendbanime
b) Grumbullimi falas për familjet sociale
c) Fushata e informimit ne media (radio dhe televizion)
d) Aksione për ditët: tokës, mjedisit,ujit, biodiversitetit etj.
e) Fletushka

## Kostoja financiare

Kostot operacionale të Ndërmarrjes së mbeturinave përbehen nga një numër i komponentëve të ndryshme. Secila prej komponentëve është përshkruar më poshtë dhe propozimet e përdorura janë paraqitur në llogaritje.

## Mirëmbajtja dhe amortizimi

Një nga komponentët kryesore të kostove përfshin mirëmbajtjen dhe amortizimin e automjeteve dhe shportave të nevojshme për të siguruar shërbimet e administrimit të mbeturinave.

Tabela e mëposhtme paraqet asetet e domosdoshme dhe shpenzimet e përsëritura nga këto asete, si blerja dhe mirëmbajta e kamionëve teknologjik. Normat e mëposhtme të amortizimit dhe mirëmbajtjes janë përdorur zakonisht nga normat e raportit në sistemet e administrimit të mbeturinave.

**Mirëmbajtja përfshin edhe automjetin ekzistues të mbeturinave**

Një tjetër komponentë e kostos është edhe amortizimi dhe mirëmbajtja/lyerja e shportave që përdoret edhe për dezinfektimin e tyre, kur të bëhet grumbullimi i mbeturinave në këto lokacione.
Tabela e mëposhtme paraqet një vlerësim të këtyre kostove operacionale.

## Fuqia punëtore

Një komponent tjetër është kostoja e fuqisë punëtore. Është menduar që të punësuarit do të bëjnë grumbullimin e mbeturinave dy herë në javë në pjesën urbane dhe tri herë në javë në pjesën rurale, duke i pastruar dhe mirëmbajtur shportat e mbeturinave dhe rrugët pranë. Ata pastaj do të transportojnë mbeturinat në deponinë e përhershme regjionale në "Sverk të Thatë"-Pejë.

Plani i trajnimit është në përputhje me kërkesat e tregut dhe nevojat e ndërmarrjes për një produktivitet cilësor.

| Nr. | Emri i trajnimit | Personeli | Organizimi i Trajnimit |
|---|---|---|---|
| 1. | Marrëdhënie me publikun / klientët | Punëtoret e informacionit / shitjes | I brendshëm |
| 2. | Procedura Administrative | 25% e stafit të ndërmarrjes | I brendshëm |
| 3. | Raportimi | Udhëheqësit e departamenteve | I jashtëm |
| 4. | Menaxhimi i resurseve Humane &Plani Strategjik | Udhëheqësit e departamenteve | I jashtëm |
| 5. | Qeverisje korporative dhe trajnime Profesionale | Bordi / Menaxhmenti | I jashtëm |

*Tabela 9. Planifikimi i trajnimeve sipas strukturës dhe nivelit*

Marrëdhënie me Publikun/Klientët: Gjatë implementimit të këtij plani do të dërgohen shume lende te përmbaruesi qe kërkon një marrëdhënie mjaft mirë me klientët pasi qe kjo pjese e klientëve janë shume te revoltuar.

Procedurat Administrative: pasi që kemi aplikuar procedura të reja administrative, duhet që i gjithë stafi të familjarizohen me këto proceduara.

Raportimi: Pasi që çdo ditë rriten kërkesat për raportime të ndryshme nga stafi drejt menaxhmentit dhe menaxhmenti ndaj komisioneve, bordit dhe institucioneve të ndryshme, atëherë për një raportim i cili përmban informatat e nevojshme për grupet e interesit duhet që të mbahen trajnime të rregullta.

Planifikimi Strategjik: Planifikimi është një ndër pikat kyçe për suksesin e një ndërmarrjeje dhe është e nevojshme që të investohet në këtë drejtim për ngritjen profesionale të udhëheqësve të departamenteve.

Qeverisja Korporative dhe Trajnimet Profesionale: Trajnimet për qeverisje korporative janë të obliguara sipas ligjeve në fuqi. Kurse trajnimet profesionale janë të domosdoshme që stafi menaxhues të jetë në kohezion me të rejat shkencore dhe ndryshimet e legjislacionit dhe standardet ndërkombëtare.

## Tarifat dhe të Hyrat

Kuvendi Komunal do të përcaktojë tarifat që do të paguhen për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Komuna do t'i bazojë tarifat në parimin e pagesës nga ndotësit sipas të cilit të gjithë gjeneruesit e mbeturinave do të duhet të paguajnë për mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave që ata krijojnë. Bizneset e mëdha, të cilët përdorin kontejner të mbeturinave prej 1.1 $m^3$ l apo të veçantë sipas veprimtarisë së tyre do të duhet të paguajnë një tarifë më të lartë për njësi (vëllim) të mbeturinave të krijuara, krahasuar me ato të amvisërisë. Lartësia e tarifave fillimisht do të bazohet sipas vendimit të asamblesë komunale.

Të ardhurat totale nga tarifat e grumbullimit të mbeturinave do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e përgjithshme të ofrimit të mbledhjes së mbeturinave dhe shërbimit të pastrimit të rrugëve e deri të deponimi.

Në mënyrë që të sigurohen të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, do të aplikohet një metodë pro-aktive e mbledhjes së tarifës si dhe sanksionet për mos pagesë. Gjeneruesve të mbeturinave do t'ju kërkohet që të paguajnë shërbimet e grumbullimit të mbeturinave në zyrat NP-së, por ata që nuk e bëjnë do të aplikohen masat ndëshkuese. Në këto raste, një kosto e tarifës për mbledhje prej 10% të tarifës së mbeturinave do t'i shtohet tarifës së mbledhjes së mbeturinave.

Për hedhjen e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi në lokacione për mbushje, një tarifë do të aplikohet. Tarifa do të përcaktohet nga asambleja Komunale. Në tabelën e mëposhtme tregohen të hyrat e planifikuara në Euro përmes mbledhjes së tarifave:

| Veprimtaritë | Nr. | Çmimi/muaj/1 | Çmimi/vit/1 | Totali/vit |
|---|---|---|---|---|
| Ekonomitë Familjare/Amvisëritë | 6000 | 6.0 € | 36.000 € | 432.000 € |
| Konsumator jo rezident | 1600 | 1.5 € | 2.400 € | 28.800 € |
| Bizneset e mesme, te medha | 600 | 15.67 | 9.402 | 112.824€ |
| Të hyrat e planifikuara nga kontratra në shtepi | | | | 263.610 |
| Totali | | | | 837.234€ |

*Tabela 10. Të hyrat sipas veprimtarisë më çmimin e ri*

Shuma e lartshënuar e të hyrave është në rastin kur ato mblidhen mbi 90%. Vlera e parashikuar e mbledhjes së tarifave në fazën fillestare për 90% është 837.234.00 € . Kjo shumë e planifikuar mendohet të jetë e mjaftueshme për vitin 2023 për ofrimin e shërbimit për qytetarët.

## Të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara të Ndërmarrjes për vitet 2023

## RRJEDHA E PARASË E PLANIFIKUAR NË VITIN 2023

### VITI KALENDARIK 2023

| Zërat | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Faturimet | | | | | | | | | | | | | |
| Të hyrat nga veprimtaria | 47.800 | 47.800 | 47.800 | 47.800 | 47.800 | 47.800 | 47.800 | 47.800 | 47.800 | 47.800 | 47.824 | 47.800 | 573.624 |
| Të hyrat tjera | 21.967 | 21.967 | 21.967 | 21.967 | 21.967 | 21.967 | 21.967 | 21.967 | 21.967 | 21.967 | 21.967 | 21.967 | 263.610 |
| Total të hyra | 69.767 | 69.767 | 69.767 | 69.767 | 69.767 | 69.767 | 69.767 | 69.767 | 69.767 | 69.767 | 69.767 | 69.767 | 837.234 |
| | | | | | | | | | | | | | |
| KMSH | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | |
| Shpenzimet Administrative | 1.400 | 1.500 | 1.700 | 1.300 | 1.450 | 1.100 | 1.050 | 1.350 | 1.000 | 1.100 | 1.850 | 1.860 | 16.660 |
| Shpenzimet për bruto AP | 25.700 | 25.700 | 25.700 | 25.700 | 25.700 | 25.700 | 25.700 | 25.700 | 25.700 | 25.700 | 25.700 | 25.700 | 308.400 |
| Shpenzimet për Derivate | 15.000 | 14.000 | 15.000 | 14.500 | 15.000 | 14.500 | 16.000 | 17.000 | 15.000 | 15.000 | 15.500 | 16.000 | 182.500 |
| Shpenzimet për Servisim | 3.900 | 3.900 | 3.900 | 3.900 | 3.900 | 3.900 | 3.900 | 3.900 | 3.900 | 3.900 | 3.900 | 3.900 | 46.800 |
| Shpenzimet tjera për autogoma | 2.400 | 2.400 | 2.400 | 2.400 | 2.400 | 2.400 | 2.400 | 2.400 | 2.400 | 2.400 | 2.400 | 2.500 | 28.900 |
| Shpenzimet për vegla punë | 2.350 | 2.350 | 2.350 | 2.350 | 2.350 | 2.350 | 2.350 | 2.350 | 2.350 | 2.350 | 2.350 | 2.350 | 28.200 |
| Shpenzimet për pemë dekorative,lula | 1.320 | 1.320 | 1.320 | 1.320 | 1.320 | 1.320 | --- | --- | --- | --- | --- | --- | 7.920 |
| Shpenzimet për amortizim | 6.000 | 6.000 | 6.000 | 6.000 | 6.000 | 6.000 | 6.000 | 6.000 | 6.000 | 6.000 | 6.000 | 6.000 | 72.000 |
| Shpenzimet të deponis | 3.000 | 3.000 | 3.000 | 3.000 | 3.000 | 3.000 | 3.000 | 3.000 | 3.000 | 3.000 | 3.000 | 3.000 | 36.000 |
| Shpenzimet për uniforma dimrore-verore | --- | --- | --- | 340.0 | 340.0 | 340.0 | 340.0 | 340.0 | 340.0 | 340.0 | 340.0 | 340.0 | 3.060 |
| Furnizimi më aparate zjarrit | 222 | 222 | 222 | 222 | 222 | 222 | 222 | 222 | 222 | 222 | 222 | 224 | 2.666 |
| Furnizimi më kapak të betonit | -- | 245.0 | 245.0 | 245.0 | 245.0 | 245.0 | 245.0 | 245.0 | 245.0 | 245.0 | 245.0 | 254.0 | 2.704 |

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Mirëmbajtja e web,faqes | -- | -- | -- | -- | -- | -- | 116.0 | 116.0 | 116.0 | 116.0 | 116.0 | 120.0 | 700.0 |
| Angazhimi i një konsulenti indiviual | -- | 500.0 | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | -- | 500.0 |
| Sigurimi i Automjetevë | 833.0 | 833.0 | 833.0 | 833.0 | 833.0 | 833.0 | 833.0 | 833.0 | 833.0 | 833.0 | 833.0 | 837.0 | 10.000 |
| Shpenzimet për eliminimin deponi ilegale | 5.830 | 5.830 | 5.830 | 5.830 | 5.830 | 5.830 | 5.830 | 5.830 | 5.830 | 5.830 | 5.830 | 5.870 | 70.000 |
| Totali i planifikimit të shpenzimev | 67.955 | 67.800 | 68.500 | 67.940 | 68.590 | 67.740 | 67.986 | 69.286 | 66.936 | 67.036 | 68.286 | 68.955 | 817.010 |
| Fitimi i Planifikuar | 1.812. | 1.967. | 1.267. | 1.827. | 1.177. | 2.027. | 1.781. | 481.5 | 2.831. | 2.731. | 1.505. | 812.5 | 20.224 |

Kryesuesi i Bordit:

Milazim Mushkolaj

N.P.L"HIGJIENA"SH.A.DEÇAN

811299082 SH.A. HIGJIENA DEÇAN